



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:100237
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06238019

K.DH.SH.II.nr.597/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Inspektorati Farmaceutik” me seli në Instituti B, kati përdhese, rrethi i QKUK-së në Prishtinë, kundër debitorit “B.B.” B.I., me NUI 811282756 dhe seli në rrugën Hoxhë Januzi në Viti, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.298/2023 të datës 29.12.2023, me datën 01.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “B.B.” B.I., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.298/2023 të datës 29.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.298/2023 të datës 29.12.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “B.B.” B.I., me NUI 811282756 dhe seli në Viti, i ushtruar kundër urdhrorit përmbarimor P.nr.480/2022 të datës 02.12.2022 të përmbaruesit privat Sefer Arifi me seli në Gjilan.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Inspektorati Farmaceutik” me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbartim zyrën e përmbartuesit privat Sefer Arifi me seli në Gjilan, me të cilin ka kërkuar që nga debitori “B.B.” B.I., dhe të dhëna tjera si në hyrjen e këtij aktvendimit, të realizoj kërkesën në shumën prej 1,000.00€ dhe shpenzimet procedurale të procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim ia kishte bazuar në vendimin e tij nr.10/F-014-20 të datës 05.05.2020 i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2022, të cilin në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Përmbartuesi më 02.12.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.480/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit.

Debitori më 09.02.2023 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që të pranohet prapësimi dhe të anulohet urdhri. Ai ka deklaruar se Propozimi është bërë me nguti, pasi Urdhri është lëshuar në të njëjtën ditë me ushtrimin e Propozimit. Sipas tij, dispozitat e LPP-së parashohin që para se të parashtrohet propozimi, kreditori duhet të dëshmoj dhe argumentoj propozimin e tij, gjë që nuk e ka bërë. Ka shtuar se në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ka ushtruar padi për konflikt administrativ për prishjen e vendimit nr.10/K-39-20 të datës 17.06.2020 të Inspektoratit Shëndetësore pran Ministrisë së Shëndetësisë, andaj është dashur që Kreditori të pres deri në marrjen e formës së prerë të vendimit lëndor, e pastaj ta dërgoj propozimin për përmbartim të këtij vendimi. Shton se dokumenti i dhënë në procedurën administrative nuk e ka klauzolën e përmbartueshmërisë, andaj konsideron se urdhri i përmbartuesit privat është i ngutshëm dhe i parakohshëm. Prapësimi ia ka bashkëngjitur në kopje vendimin nr.10/F-014-20 të datës 05.05.2020, vendimin nr.10K-39-20 të datës 17.06.2020 dhe padinë për konflikt administrativ, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me prapësimin.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim, edhe pse ishte udhëzuar nga Përmbartuesi për këtë të drejtë

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimi ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.298/2023 të datës 29.12.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “B.B.” B.I., me NUI 811282756 dhe seli në Viti, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.480/2022 të datës 02.12.2022 të përmbartuesit privat Sefer Arifi me seli në Gjilan.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nga vultat përkatëse që gjenden në vendim gjykata konstaton se vendimi lëndor është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm që nga data 02.09.2022. Në shkresat e lëndës nuk ka prova nga të cilat do të rezultojnë se debitori e ka përmbushur detyrimin monetar që rezultojnë nga vendimi i cekur më lartë. Përveç kësaj, debitori nuk ka sjellë prova me të cilat do të provohet se vendimi është anuluar, është ndaluar ekzekutimi i tij ose në ndonjë formë është shpallur i pavlefshëm.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi nr.10/F-014-20 i datës 05.05.2020, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi nr.10/F-014-20 të datës 05.05.2020 është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 02.09.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.597/24 me datë 01.10.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami